


Si të shkarkosh “Çertifikatën Elektronike” & ta regjistrohsh në eBiznes

1. Identifikohu në e-Albania me kredencialet e biznesit
2. Kërko “Aplikim për çertifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit”
3. Kliko butonin “Përdor”
4. Plotësoni të dhënat e kërkuara në formular si: NIPT, Emri i subjektit, Numri i kontaktit, email, Emri i Përfaqesuesit të subjektit, Adresa edhe Qyteti.
5. Në fund të formularit, kliko butonin “Dërgo”
6. Pagesa e çertifikatës mund të kryhet nepërmjet një karte debiti apo krediti ose në bankë me faturen e arketimit.
7. Çertifikata elektronike bashkë me një password vjen tek adresa e emailit të regjistruar në portalin e-Albania brenda 3 ditëve. Sigurohu që në portal keni regjistruar një adresë emaili në të cilën keni akses.
8. Pas marrjes së çertifikatës në email, shkarko çertifikatën në aparatit celular ose tablet.
9. Hyr në aplikacionin eBiznes.
10. Kliko “Regjistro çertifikatë”
11. Plotëso të dhënat e kompanisë si NIPT, Numrin e ID-së personale, email-in, numrin e kontaktit.
12. Ngarko çertifikaten duke klikuar “Zgjidh skedar”
13. Vendos fjalëkalimin e çertifikatës që ka ardhur në email.
14. Kliko “Tjetra”



Regjistrimi i Kodit të Njesisë së Biznesit

1. Identifikohu me kredencialet e eAlbania tek portali Self Care i Platformës Qëndrore të Faturave
2. Navigo tek menu Fiskalizimi
3. Kliko “Vendet e Ushtrimit të Veprimtarisë së Biznesit”
4. Kodin e gjen nën kategorinë “KODI” i Njesisë së Biznesit në të cilin ke aktivizuar llogarinë eBiznes
5. Hyr në eBiznes App për të regjistruar kodin
6. Shto kodin tek fusha me emrin Kodi i Njesisë së Biznesit
7. Kliko butonin “Ruaj”

Nëse keni nevojë për ndihmë, na telefononi në 149 ose na shkruani në Whatsapp +355696000149.